



# Qeveria e Republikës së Shqipërisë

## Plan Veprimi

### Iniciativa “Open Government Partnership”

Prill 2012



“Një punë e madhe për transparencën në të gjitha praktikat, është bërë, por duhet ta vazhdojmë këtë betejë në mënyrë të pareshtur, çdo orë, çdo minutë, çdo ditë.”- Kryeministri i Shqipërisë SHTZ. Sali Berisha, 2011

#### Hyrje

Qeveria shqiptare e sapozgjedhur në vitin 2005 shpalli prioritet rritjen e transparencës në shërbimet qeveritare, ndërsa në programin qeverisës 2009-2013, duke e parë modernizimin dhe përdorimin e teknologjive të reja si një rrugë të shpejtë zhvillimi, shpalli programin "Shqipëria digjitale" si ndër projektet e saj madhorë, duke rikonfirmuar angazhimin e saj për të ecur drejt rrugës së një ekonomie të bazuar në njohuritë dhe krijimin e një shoqërie të informacionit.

Shqipëria e nisi këtë rrugë, në fillim të vitit 2006, me një penetrim të internetit 4.8 %. Sot përqindja e penetrimit të internetit është afro 60% ndërsa sipas botimit të Forumit Ekonomik Botëror shqiptarët janë shndërruar ndër qytetarët më pasionantë pas internetit, në Evropë, të cilët kanë shënuar rritjen e dytë më të shpejtë në botë në këtë fushë, në vitet 2006-2010. Shqiptarët kanë sot, shkallën e përdorimit të telefonisë celulare ndër më të lartat në Evropë. Penetrimi i telefonisë celulare në Shqipëri në fund të vitit 2011 arriti në 185%. Kjo shifër, që e renditi Shqipërinë të 18-ën në renditjen botërore, është më lartë se mesatarja evropiane.

Shqipëria është vendi i parë në botë, që realizoi prokurimet publike 100% elektronike dhe në vitet e fundit është bërë një progres i ndjeshëm, në drejtim të qeverisjes elektronike, lehtësimit të biznesit përmes kryerjes së shërbimeve online, si regjistrimi i biznesit përmes ngritjes së Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit dhe të Licencimit të bizneseve, me digjitalizimin e Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile të shtetasve, në drejtim të edukimit, përmes krijimit të kabineteve të informatikës nëpër shkolla, e vijuar më pas me ofrimin e shërbimeve të qeverisjes nëpërmjet internetit në sistemin e tatim-taksave, sistemin doganor, regjistrimi online i automjeteve dhe shumë shërbime të tjera të digjitalizimit të e-qeverisjes, të cilat po integrohen në renë kompjuterike.

Në 100-vjetorin e pavarësisë së saj, Shqipëria synon të jetë një vend me qeverisje digjitale.

Në lançimin e iniciativës së OGP-së në New York, më 21 shtator 2011, Kryeministri Z. Sali Berisha u shpreh: “Shqipëria është një vend që po bën përpjekjet më serioze në drejtim të një qeverisjeje më transparente. Në këtë Forum, Shqipëria gjen një frymëzim dhe angazhohet të zbatojë një për një të gjitha zotimet e angazhimet që rrjedhin nga anëtarësia në këtë nismë.”

Qeveria shqiptare është fokusuar në zbatimin e sfidave të mëposhtme të OGP-së:

#### Sfida 1: Rritja e integritetit publik

## 1.1 Open Data

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, ka filluar punën për hartimin e një portali me të dhëna qeveritare të formatit *open data*, të cilat do të përfshijnë fillimisht të dhënat e Ministrisë së Financave, Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit për të gjitha shpenzimet e një dite ([http://www.minfin.gov.al/minfin/Pages/a te kryera nga Drejtoria e Pergjithshme e Thesarit 1890 1.php](http://www.minfin.gov.al/minfin/Pages/a%20te%20kryera%20nga%20Drejtoria%20e%20Pergjithshme%20e%20Thesarit%201890%201.php)). Në performancën aktuale këto të dhëna janë pranë standardit të kërkuar dhe modelit *Open Budget*.

E njëjta praktikë do të zbatohet edhe me publikimin e të dhënave të rregullatorit, Autoritetit Kombëtar të Komunikimeve Elektronike e Postare, AKEP (<http://www.akep.al>).

Instituti Kombëtar i Statistikave, (INSTAT) në një plan më afatgjatë, do të kthejë në *open data* të dhënat që ky institut mbledh. INSTAT si koordinator kombëtar i të dhënave mbi ekonominë dhe shoqërinë shqiptare do të duhet të standardizojë, brenda një harku kohor më të gjatë, tërësisht procesin e publikimit të të dhënave statistikore të sektorit publik. Ky objektivi përkon edhe me Direktivat e fundit të Komisionit Evropian për publikimin e të dhënave publike. Ky proces do të vijojë më vonë me të dhënat e të gjitha institucioneve e agjencive qendrore.

## 1.2 Qeverisja elektronike 2012 e në vazhdim

Shumë nga shërbimet publike në Shqipëri për biznesin dhe publikun janë online dhe kjo ka ndihmuar në mirëqeverisje, dhe përmbushjen e objektivave të qeverisë për rritje të transparencës dhe zvogëlim të korrupsionit.

Sistemi e-Cabinet, filluar në Mbledhjen e Qeverisë në vitin 2009, si dhe platforma e re e vitit 2012 e-Aktet bëri pjesë të sistemit mbi 1500 nëpunës të ministrive, duke përfshirë të gjithë hapat e nevojshme për hartimin akteve ligjore dhe nënligjore, në një procedurë tërësisht elektronike. Ky proces po pasohet nga zbatimi i sistemeve e-Parlament, më tej e-President dhe e-Publication, pra Gazeta Zyrtare Elektronike, sisteme të cilët do të kompletojnë procesin e hartimit dhe miratimit të legjislacionit në mënyrë digjitale, duke kursyer kohë dhe shpenzime.

Gjatë vitit 2012, do të vijohet me zgjerimin e rrjetit qeveritar Govnet duke mundësuar ofrimin e shërbimeve të përqendruara për qeverisjen elektronike, jo vetëm në Tiranë, por edhe në qeverisjen lokale, në qarqet kryesore të vendit. Vitin e ardhshëm shumë shërbime thelbësore të shtetit, si për pronën private dhe shëndetësisë, planifikojmë t'i kthejmë në digjitale.

Brenda vitit 2012, do të ndërtohet Infrastruktura e Ndërveprimit të e-Qeverisjes (e-Government Interoperability Framework- e-GIF) e cila do të mundësojë shkëmbimin e informacionit ndërmjet institucioneve të Administratës Publike. Kjo infrastrukturë do të manaxhohet nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe do të mundësojë ofrimin e shërbimeve tërësisht elektronike. Në këtë mënyrë do të rritet efienca dhe transparenca e institucioneve të Administratës Publike, në përputhje me standardet evropiane të mbrojtjes së të dhënave personale.

Pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit po ndërtohet një *Datacenter* Qendror, me standarde të larta, që do të mundësojë që të gjithë shërbimet online të jenë të qendëruara dhe të integruara.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave do të realizojë disa objektiva në lidhje me informacionet që do t'i ofrohen operatorëve ekonomikë, nëpërmjet qasjes në internet. Në korrik 2012, do të zbatohet sistemi i

Akcizës që përfshin akses dhe shërbim online për operatorët ekonomikë. Sistemi do të mundësojë kontrollin online: të statusit të deklaratës, të tranzitit dhe të llogarisë, si dhe do të përgatiten kushtet për realizimin e pagesave online nga operatorët.

Administrata Tatimore do të hartojë, gjatë këtij viti, termat e referencës si dhe tenderimin për fillimin e zbatimit të plotë të sistemit e-Tax. Ky projekt ka për qëllim të zëvendësojë të gjithë sistemin tatimor aktual dhe të gjitha nënsistemet për t'i integruar në një sistem të vetëm. (<http://www.tatime.gov.al>) Gjithashtu brenda vitit 2012 do të zhvillohet sistemi i deklarimit të të ardhurave personale (G2C) dhe do të zhvillohet gradualisht teknologjia M-service, me anë të të cilit do t'i ofrohet mundësia çdo individit të shohë situatën e tij tatimore, me anë të telefonit celular, duke mos u kushtëzuar vetëm te kompjuteri.

Në edukim, Qeveria shqiptare, në vitin 2006, reformoi sistemin e dhënies së provimeve të Maturës Shtetërore. Këtë vit do të implementohet procesi i Maturës Shtetërore online që do të rrisë cilësinë, saktësinë, efektivitetin dhe do të lehtësojë qasjen më të madhe në informacion dhe shërbime për të gjitha grupet e interesit. (<http://www.mash.gov.al>)

Për herë të parë në Shqipëri, Agjencia Kombëtare e Provimeve, në janar-shkurt 2012, organizoi provimin e profesioneve të rregulluara, duke zhvilluar një standard ndërkombëtar të provimit tërësisht digjital, me transparencë maksimale dhe një numër të ulët ankimesh. (<http://www.akp.gov.al>)

Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar—përmban bazën e të dhënave të nxënësve të sistemit parauniversitar bashkë me numrin e amzës, dhe informacion mbi stafin pedagogjik. Ky sistem rrit ndjeshëm cilësinë në shërbimet që ofrojnë strukturat arsimore të sistemit parauniversitar duke monitoruar performancat, prodhuar statistika e tregues, si dhe thjeshtësuar inspektimet e auditimet.

Sistemi SIMS – që është duke përfunduar, përmban databazën e plotë për të gjitha të dhënat e infrastrukturës dhe inventarizimin e shkollave.

Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL) do të përfundojë këtë vit procesin e digjitalizimit të sistemit të menaxhimit, një mekanizëm që do të lehtësojë procedurat e vlerësimit dhe akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe do të shërbejë për fuqizimin e bashkëpunimit dhe mirëinformimit me grupet e interesit dhe publikun e gjerë.

Në prill 2012 pritet të lancohet moduli i parë i sistemit U-Gov - një sistem në shërbim të universiteteve për menaxhimin e brendshëm të informacionit. Benefitet e përgjithshme:Ulja e kohës në përpunim dhe në shpërndarje të të dhënave, ulja e kostove për transksionet financiare dhe rritja e eficiencës në menaxhimin e burimeve e strukturave arsimore.

Në sektorin e drejtësisë, gjatë 6-mujorit të dytë 2012, do të zbatohet inspektimi online i gjykatave dhe çështjeve gjyqësore në vend, që është një nga funksionalitetet e reja që ofron Sistemi i Informacionit i Integruar për Menaxhimin e Çështjeve Gjyqësore (ICMIS), duke përshpejtuar maksimalisht kohën e kërkuar për hartimin e raporteve për çështjet e inspektuara. Një tjetër nismë në proces, në sektorin e drejtësisë, është digjitalizimi i transferimit të dosjes/çështjes në shkallët e sistemit gjyqësor. Kjo nismë do të ulë ndjeshëm kohën e regjistrimit dhe të procedimit të çështjes gjyqësore.

Në lidhje me punësimin, brenda vitit 2012, do të zbatohet projekti e-Punësimi, me synimin e digjitalizimit të informacionit në të gjitha zyrat e punësimit, konsolidimin e bazës së të dhënave për tregun e punës, si dhe krijimin e regjistrimit të punëkërkuësve dhe punëdhënësve ([www.kerkojune.gov.al](http://www.kerkojune.gov.al)).

Po këtë vit do të ndërtohet faqja e Internetit të Shërbimeve Sociale, ku do të publikohet Harta e këtyre shërbimeve në gjithë Shqipërinë ([www.sherbimeshoqerore.gov.al](http://www.sherbimeshoqerore.gov.al) ), si dhe do të realizohet një ristrukturim i të dhënave për shërbimin e barazisë gjinore (<http://www.mpcs.gov.al/dps hb> )

Për procedurat e konçensioneve dhe të dhënat e planifikimit të territorit do të jepet mundësia e aplikimit online në faqen e internetit të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (MPPT) për licensa të kategorive të ndryshme <http://www.mppt.gov.al> .

Në kuadër të rritjes së transparencës në procesin e menaxhimit të personelit Ministria e Mbrojtjes do të publikojë përgjatë vitit 2012 statistikat e burimeve njerëzore për të mundësuar monitorimin e rekrutimit, dhe ngritjes në detyrë, si dhe do të ngrëjë një sistem online të digjitalizimit, kontrollit, inventarizimit dhe kontabilitetit të materialeve logjistike.

Ministria e Brendshme (MB) krijoi në vitin 2009 Rregjistrin Kombëtar elektronik të Gjendjes Civile dhe sot mundëson dhënien online të dokumentave të gjendjes civile nga 354 zyra të gjendjes civile të lidhura me bazën qendrore të të dhënave. Të gjitha dokumentat e gjendjes civile sigurohen online në rreth 10 sekonda sipas standardeve më të mira të operimit elektronik. Gjithashtu kjo ministri ngriti sistemin e Prodhimit të Dokumentave të Identitetit, nëpërmjet aplikimit elektronik, si dhe sistemin MEMEX, për të gjitha rekordet kriminale, sistem i cili bën të mundur operimin e policisë së shtetit dhe lidhjen online me bazat e tjera të rekordeve kriminale, veçanërisht ato të Interpol; Europol etj.

MB po planifikon të krijojë një platformë të formatit *open data* për policinë e shtetit, si dhe do të fillojë publikimin në faqen zyrtare të saj të raporteve të kontrollit, auditit dhe inspektimit.

### **1.3 Rritja e Aksesit të qytetarëve në vendimmarrje**

#### **1.3.1 Ligji për informimin dhe konsultimin publik**

Qeveria shqiptare dhe Ministria e Drejtësisë janë angazhuar të amendojnë brenda këtij viti ligjin ”Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare”, bazuar në një konsultim të gjerë me organizatat e shoqërisë civile, me qëllim përmirësimin apo qartësimin e dispozitave ligjore. (Nr. 8503, datë 30.06.1999).

Gjithashtu Ministri për Inovacionin dhe TIK do të hartojë një ligj të posaçëm “Për njoftimin dhe konsultimin” për rregullimin ligjor të proceseve konsultuese të strukturuar me aktorë të shoqërisë civile, grupet e interesit duke përfshirë partnerët ekonomikë dhe socialë.

#### **1.3.2 User friendly website**

Në kuadër të OGP-së Qeveria shqiptare po kryen një studim për gjithë faqet zyrtare të internetit të institucioneve dhe agjencive qendrore për t’i kthyer ata në *user friendly*. Gjithashtu ka nisur një inspektim i faqeve zyrtare të internetit të institucioneve lokale në vend dhe pritet që të ketë një përmirësim dhe përditësim të këtyre faqeve.

Në këtë kuadër, për të rritur aksesin e qytetarëve në konsultimet publike sidomos në aktet ligjore të hartuara nga Qeveria shiptare, është ngritur Regjistri i Legjislacionit të Biznesit (<http://www.rlb.gov.al>), ku përveç aksesimit të akteve në fuqi, deri në nivel udhëzimi/urdhëri, jepet dhe mundësia e komenteve të projektakteve ligjore. Gjithashtu disa institucione qendrore kanë filluar të publikojnë aktet ligjore, për marrjen e mendimeve/sugjerime nga publiku në faqet sociale Facebook, Twitter apo linked in: (<http://www.facebook.com/Mitik.gov.al>; <http://twitter.com/#!/mitikgoval> ); [Këshilli Teknik për Qeverisjen Elektronike | LinkedIn](#)

Një iniciativë në përputhje me këtë është që Ministria e Punëve Publike dhe Transportit (MPPT) do të zbatojë gjatë vitit tjetër aplikimin e thjeshtëzuar online për procedurat e konçensioneve për të gjitha asetet shtetërore në administrim të MPPT, të cilat do të kryhen direkt në faqen e internetit të ministrisë nëpërmjet formularëve standardë interaktivë.

### 1.3. 3Ankimimi publik

Gjatë vitit 2012 do të zhvillohet nga Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit projekti *Tracking* apo Gjurmueshmëria, një funksionalitet, i cili do t'i mundësojë çdo qytetari apo biznesi, që aplikon në një zyrë shtetërore, të ndjekë online ecurinë e aplikimit deri në përgjigjen zyrtare, me qëllim rritjen e efikasitetit të punës së administratës publike, si dhe rritjen e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies.

Policia e Shtetit dhe Ministria e Brendshme (<http://moi.gov.al>) do të krijojnë gjatë këtij viti një sistem të konsoliduar të dhënash në lidhje me regjistrimin e hetimeve, ndjekjes penale dhe dënimeve në fushën e korrupsionit. Po gjatë këtij viti do të bëhet i mundur plotësimi online i formularit të ankesave nga shtetasit, në faqen e internetit të Shërbimi të Kontrollit të Brendshëm, [http://moi.gov.al/?page\\_id=967](http://moi.gov.al/?page_id=967).

Nga qershori 2012 e deri në fund të vitit do të zbatohen projektet e digjitalizimit të sistemit të noterëve, si dhe do të standardizohet shqyrtimi i ankesave të publikut, veçanërisht për çështjet e pronësisë.

Ministria e Drejtësisë (MD) nis këtë viti realizimin e projektit për ankimimin dhe përpunimin online të ankesave të qytetarëve në MD dhe Këshillin e Lartë të Drejtësisë (KLD). Synimet e projektit janë: që të shkurtojnë kohën e ankimimit të qytetarëve ndaj gjyqësorit, të rrisin transparencën e përpunimit të ankesave, si dhe të shmangin mbivendosjen mes KLD-së dhe MD-së gjatë kontrollit të gjyqësorit.

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE) ngriti, në vitin 2009, portalin e Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorit [www.kmk.al](http://www.kmk.al), ku çdo qytetar mund të gjejë informacionet e duhura për të drejtat e konsumatorëve, por dhe të ankohet online për shkeljet, praktikat e pandershme tregtare, apo abuzimet.

Në kuadër të inspektimit në punë, përveç publikimit të një numri telefoni falas në rubrikën e faqes së internetit të Inspektoratit Shtetëror të Punës [www.sli.gov.al](http://www.sli.gov.al), në faqen e internetit, do të mund të bëhet një ankesë online, apo mund të denoncohen rastet e shkeljeve të konstatuara. Qëllimi është realizimi në kohë i shqyrtimit të ankesës dhe i marrjes së masës së duhur. Po ashtu, Ministria e Mbrojtjes, për të rritur ndërgjegjësimin e personelit në kuadër të nismave kundër korrupsionit, do të publikojë tre linja telefonike fikse pa pagesë. Kjo praktikë tashmë zhvillohet nga një sërë institucionesh qendrore: përmendim numrin e telefonit falas për emergjencat, publikuar në faqen e internetit të Ministrisë së Brendshme.

Për fuqizimin e mëtejshëm të transparencës me publikun gjatë vendimmarrjes së politikave dhe iniciativave ligjore, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave (MMPAU), do të aplikojë këtë vit disa seminare për konsultim publik, në lidhje me shpalljen e Zonave të Mbrojtura (harta përkatëse në [http://www.moe.gov.al/index.php?option=com\\_content&view=article&id=56&Itemid=69](http://www.moe.gov.al/index.php?option=com_content&view=article&id=56&Itemid=69)), do të kryejë këshillime publike për të gjitha aktet ligjore të planifikuara për miratim, do të nxisë takime të shpeshta të Bordit për zbatimin e Konventës së Aarhusit në Shqipëri si dhe do të botojë në faqen e saj të internetit të gjitha lejet e mjedisit që lëshon kjo ministri: ([http://www.moe.gov.al/index.php?option=com\\_content&view=article&id=100&Itemid=81](http://www.moe.gov.al/index.php?option=com_content&view=article&id=100&Itemid=81))

Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MBUMK) do të publikojë këtë vit në faqen e internetit, për konsultim me publikun, afro 50 akte ligjore dhe nënligjore në fushën e zhvillimit rural, sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit. (<http://www.mbumk.gov.al>)

Zyra e Shërbimit Turistik, pranë Ministrisë së Kulturës prej disa vitesh shqyrton ankesat e shtetasve, vendas ose të huaj, kundrejt sipërmarrjeve turistike për mallrat dhe shërbimet e ofruara. Në këtë kuadër, të gjithë konsumatorët e shërbimeve turistike mund të ankohen drejtëpërdrejt, me postë apo në rrugë elektronike, nëpërmjet formularit të ankesës i cili gjendet në faqen zyrtare të këtij institucioni: [www.zsht.gov.al](http://www.zsht.gov.al).

## **Sfida 2: Përmirësimi i shërbimit publik**

### **2.1 Digjitalizimi për të përmirësuar shërbimin publik**

Digjitalizimi i doganave në Shqipëri, i kryer që nga viti 2008, ishte një nismë që synonte rritjen e efikasitetit të sistemit, duke mbledhur informacion në kohë reale në të gjitha pikat doganore. Objektivi është përmirësimi i sistemit doganor me anë të monitorimit të punës së doganierëve (me anë të instalimit të kamerave), si dhe rritja e nivelit të transparencës, duke informuar qytetarët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre në pikat doganore (<http://www.dogana.gov.al>).

Moduli Financiar i gjithë institucioneve arsimore -Sistemi u krijua vitin e kaluar për të menaxhuar financat dhe buxhetin e MASH e të drejtorive rajonale arsimore në një platformë dhe bazë të dhënash qendore dhe unike. Sistemi rrit cilësinë e ndërveprimit, shmang dublimin e informacionit, rrit transparencën e shpenzimeve dhe gjurmimin e tyre në mënyrë elektronike. Faza e dytë e modulit pritet të fillojë në muajin Prill 2012.

Në kuadrin e transparencës dhe antikorrupsionit në sistemin arsimor, MASH ka filluar punën për përgatitjen e Kodit të Sjelljes së Mësuesit në arsimin parauniversitar i cili informon ndër të tjera mbi veprimtaritë e lejueshme dhe të ndaluara në institucionet shkollore.

Në lidhje me trashëgiminë kulturore shqiptare, në faqen e internetit të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MTKRS) gjenden aktualisht lista e liçencave që lëshohen për restaurime dhe muze privatë, apo lista e investimeve vjetore në monumentet e kulturës.

Për të rritur eficiencën, Ministria e Shëndetësisë, krijoi një bazë të dhënash të një prej spitaleve më të mëdhenj në vend QSUT ‘Nënë Tereza’ (<http://www.qsu.gov.al>). MSH ka publikuar këtë vit në faqet e internetit të MSH (<http://www.moh.gov.al>) dhe institucioneve të varësisë të gjitha kontratat tip, protokollat e mjekimit, listën e plotë të barnave me çmimet përkatëse, së bashku me paketën bazë të shërbimeve që ofron shërbimi parësor, si dhe rezultatet e vlerësimit të plotësisimit të standardeve të institucioneve shëndetësore (<http://www.moh.gov.al/index.php?module=2&item=53>).

Në mars-tetor 2012 do të fillojë dhe zhvillohet procesi i regjistrimit audio dhe video i seancave gjyqësore, si dhe zhvillimi i trajnimeve të personelit të gjykatave për këtë proces. Materialet do të publikohen për informacion në portalin e ri të gjykatës ([www.gjykata.gov.al](http://www.gjykata.gov.al)).

Ministri për Inovacionin dhe TIK filloi këtë vit një fushatë bashkëpunimi dhe ndërgjegjësimi me operatorët mobilë dhe Internet Service Provider-at me qëllim angazhimin e këtyre aktorëve për një internet më të sigurt, sidomos për të miturit. Shumë praktika për një përdorim të kujdesshëm të telefonisë celulare nga fëmijët apo adoleshentët janë sot pjesë e praktikave të zhvilluara nga operatorët mobilë apo ISP-të në Shqipëri, përmes udhëzimeve të dhëna, broshurave të shpërndara në pikat e shitjes, etj. Por



MITIK ka inkuruar sipërmarrësit që praktikat e mësipërme të zhvillohen në një kuadër të përgjithshëm kombëtar, në një bashkëpunim për hartimin e një kodi etike të përbashkët, sipas praktikave më të mira evropiane dhe botërore, me qëllim për të krijuar një kuadër të përbashkët vetërregulles, në mbrojtje të moshave të reja dhe fëmijëve nga përmbajtjet e papërshtatshme, që mund të transmetohen përmes internetit.

Për sa i përket transparencës së financimit të partive politike, GRECO i ka adresuar Shqipërisë 7 rekomandime, të cilat janë plotësuar pothuaj plotësisht me miratimin në Kuvend të ligjit “Për partitë politike”. Ligji synon zbatimin e rregullave të detajuara në lidhje me financimin e partive politike jashtë fushatës zgjedhore; përcakton një mekanizëm të pavarur për mbikëqyrjen e financimit të partive politike jashtë fushatës zgjedhore; mundëson kontroll dhe monitorim të përgjithshëm të financimit të partive politike nga i njëjti organ: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) <http://www.cec.org.al>, si jashtë ashtu edhe brenda fushatës zgjedhore; përmirëson dhe rrit standardet e kontrollit të financimit të partive jashtë fushatës zgjedhore nëpërmjet ekspertëve kontabël të licencuar.

Në kuadër të reformës së rritjes së cilësisë në arsimin e lartë, Qendra Kërkimore e Ministrisë së Arsimit ka miratuar dhe publikuar në faqen e internetit “Rregulloren për etikën në veprimtarinë kërkimore dhe botuese”. ([http://www.mash.gov.al/File/arsimi\\_larte/rregullore-etika-veprimtari-kerkimore-botuese.pdf](http://www.mash.gov.al/File/arsimi_larte/rregullore-etika-veprimtari-kerkimore-botuese.pdf)) Rregullorja parashikon, ndër të tjera, detyrimin e institucioneve dhe kërkuesve për të publikuar dhe verifikuar me metoda bashkëkohore, në faqen zyrtare përkatëse, çdo tezë masteri shkencor, disertacion doktorate, monografi, libër, artikull shkencor apo referim, dhe forma të tjera të kërkimit dhe botimeve për të ruajtur origjinalitetin e veprës, autenticitetin dhe për të luftuar plagjiaturën. Gjithashtu publikimi i tezave në faqen zyrtare do të mundësojë që çdo studiues dhe kërkues të njihet me punimet e grupeve të tjera kërkimore, çka do të ndihmojë në përhapjen e arritjeve shkencore brenda dhe jashtë vendit.

## 2.2 Krijimi i Portalëve

Brenda vitit 2012, do të zhvillohet një portali i ri qeveritar shumë funksional, e-albania.al. Ky portal do të jetë i orientuar drejt kërkesave të përdoruesve, duke ofruar një informacion të përditësuar dhe lehtësisht të aksesueshëm nga përdoruesit. Në të ardhmen, ky portal do të shërbejë si një pikë e vetme kontakti për shërbimet e qeverisjes elektronike të ofruara ndaj qytetarëve, bizneseve dhe punonjësve të Administratës Publike.

Gjithashtu, Qeveria shqiptare do të ndërtojë portalin unik të inspektimeve, “e- Inspection”. Portali do të administrohet dhe mirëmbahet nga Inspektorati Qendror dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit. Ndërtimi i këtij portali ka një rëndësi të veçantë në koordinimin, menaxhimin, bashkërendimin, unifikimin dhe monitorimin e procedurave të inspektimit. Gjithashtu, zhvillimi i këtij portali do të ndihmojë në përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies së sistemit të inspektimit në vend si dhe në reduktimin e korrupsionit.

Do të çelet portali [www.gjykata.gov.al](http://www.gjykata.gov.al) për të ngarkuar të dhëna për qytetarët, duke përfshirë edhe publikimin e vendimeve gjyqësore.

Gjithashtu do të krijohet portali për Këshillin Kombëtar të Punës. Ky këshill ka rolin e koordinuesit të tre aktorëve kyç vendimmarrës në këtë sektor: Ministria, sindikatat, si dhe punëdhënësit.

Për përmirësimin e zbatimit të planit territorial të vendit, duke marrë në konsideratë shqetësimet e komunitetit, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorrit do të krijojë një portal për regjistrin kombëtar të planifikimit të territorit (<http://www.akpt.gov.al/default.aspx>).

I krijuar nga METE, për të rritur transparencën e procesit, portali i privatizimeve i aseteve shtetërore ([www.privatizime.al](http://www.privatizime.al)) është dizenuar në mënyrë të tillë që, pasi i interesuari bën një kërkim të thjeshtë, motorri i kërimit shumë shpejt jep rezultatet e kërkuara, dhe akoma më tepër, çdo objekt shfaqet i shoqëruar me fotot e objektit, prefektura ose qyteti ku ai ndodhet, si dhe më i rëndësishmi: statusi i objektit, pra: "në proces vlerësimi", "dërguar për shitje", apo "të miratuara për privatizim."

Për sa i përket turizmit në Shqipëri, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MTKRS) ka ngritur një portal për turizmin shqiptar <http://www.albaniantourism.com>. Ndërsa këtë vit MTKRS krijoi databazën e iso-polifonisë shqiptare, pjesë e trashëgimisë botërore sipas UNESCO-s, të publikuar në faqen e internetit: <http://www.isopolifonia.com>.

## **2.3 Audit**

Qeveria shqiptare ka miratuar një vendim në lidhje me kriteret për ngritjen e strukturave të Auditimit të Brendshëm në institucionet publike. Në kuadër të sfidës më sipër të OGP-së, gjatë këtij viti e në vazhdim çdo akt kontrolli dhe audit i administratës qendrore do të botohet në faqen zyrtare të institucionit që e realizon; Kështu p.sh.: MBMUK është angazhuar të publikojë raportet përfundimtare të kontrollit të auditit të brendshëm të Institucioneve të varësisë të kësaj ministrie, si dhe listën e përfituesve (fermerë, agrobiznese) nga skemat mbështetëse dhe produkteve të regjistruara.

## **Sfida 3: Menaxhimi më efektiv i burimeve publike**

### **3.1 Open Budget**

Mbështetur në ligjin "Për të drejtën e Informimit" si dhe iniciativës së Qeverisë shqiptare për të luftuar korrupsionin dhe për të rritur transparencën, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, ka publikuar që prej janarit të vitit 2012 listën e pagesave ditore të kryera nga të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Në këtë dokument të përditësuar pasqyrohet me detaje: Përfituesi, numri i faturës, përshkrimi saj, institucioni në të cilën dega e thesarit bën çeljen e pagesës, shumën përkatëse, si dhe datën e regjistrimit të kësaj fature në sistemin e Thesarit. Ky dokument gjendet në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave (linku me sipër të 1.1 Open Data). Në mënyrë periodike kjo ministri gjithashtu publikon online ligjin e buxhetit faktik (çdo qershor), buletin statistikor të financave, të dhënat periodike të borxhit publik, etj.

### **3.2 Prokurimet Publike**

Në vitin 2009 Shqipëria ishte vendi i parë në botë që realizoi një sistem prokurimi elektronik të detyrueshëm për të gjitha prokurimet e sektorit publik mbi pragun e 3000 Eurove. Për zbatimin e këtij projekti vendi ynë në vitin 2010 mori çmimin e dytë, *UN Public Service Award* nga OKB për vlerësimin e ekselencës në shërbimin publik. Kjo platformë e prokurimit elektronik është një aplikim *web-based*, që mundëson transaksione të sigurt midis institucioneve shqiptare publike dhe biznesit kombëtar dhe ndërkombëtar. Ky sistem ofron një administrim e përgatitje të sigurtë e transparente të të gjithë dokumentave të tenderit, duke evituar punën e panevojshme shkresore, si dhe duke siguruar të dhënat e gjithë procesit ([www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)).

Këtë vit APP do të implementojë në formë elektronike të gjitha marrëveshjet kuadër dhe do të zhvillojë elektronikisht procedurat e koncesioneve deri në fazën e hapjes së ofertave.

### **3.3 EITI**



Në vitin 2010, Qeveria shqiptare miratoi Vendimin (Nr. 540, date 07.07.2010) Për Ndjekjen e Procedurave të Anëtarësimit të Shqipërisë si vend zbatues në Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI) (<http://www.albeiti.org>).

Bazuar në rekomandimet e marra nga Sekretariati Ndërkombëtar i EITI, Sekretariati shqiptar ALBEITI, gjatë vitit 2011, hartoi planin e punës ALBEITI 2011 – 2013 dhe miratoi Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet Sekretariatit ALBEITI dhe kompanive hidrokarbure, për publikimin e të dhënave që deklarohen nga këto të fundit. Dhe aktualisht ky memorandum është nënshkruar me një pjesë të kompanive.

Gjatë 6 mujorit të dytë të 2011-ës dhe gjatë këtij viti u organizuan seminare, workshope me Grupin e Punës, grupet e interesit, shoqërinë civile, komunitetin në zonat e industrisë nxjerrëse, etj.

Bordi Ndërkombëtar i EITI i mbledhur në Xhakarta të Indonezisë në datat 25-26 tetor 2011 konkludoi se "Shqipëria ka bërë progres të konsiderueshëm ("meaningful progress") në zbatimin e EITI. Bordi Ndërkombëtar i EITI ia ka zgjatur afatin e kandidimit Shqipërisë dhe për 18 muaj të tjerë (deri në 25 prill 2013), që të plotësojë një Vlerësim, ky i fundit të tregojë përputhje me Rregullat e 2010-ës të EITI. Një ndër arsyt kryesore për këtë vendim ishte funksionimi dhe vendimmartja e Grupit Ndërinstitucional të Punës për EITI-n. Për këtë është riorganizuar dhe rikompozuar ky grup pune.

## **Mbyllje**

Qeveria shqiptare e konsultoi dhe hartoi këtë plan veprim për një periudhë 3-mujore me kontributet e gjithë institucioneve dhe agjencive qeveritare qendrore. GNP mbajti në shkurt 2012 një tavolinë të rrumbullakët me disa nga përfaqësuesit e OJQ-ve në vend, të cilët kanë ndjekur me interes zhvillimet e iniciativës OGP dhe punën e kryer nga Qeveria për këtë çështje, duke kontribuar në hartimin e këtij plan veprimi.

Konsultimi me OJQ-të dhe publikun e gjerë do të vijojë dhe jemi të besimit që do të përmirësojë këtë dokument vitin e ardhshëm. Po kështu besojmë se vitin e ardhshëm në përditësimin e plan veprimit do të përfshihen nismat që do të ndërmerren qeverisja vendore në Shqipëri.

“Vendi im, vitet e fundit ka shënuar arritje në luftën kundër korrupsionit dhe kthimin e qeverisjes në më të hapur dhe transparente për qytetarët. Jam i sigurt që pjesmarrja e Shqipërisë në OGP do të bëjë të mundur që të mësojmë nga eksperiencat e vendeve të tjera dhe gjithashtu Shqipëria t’i paraqesë vendeve anëtare apo aspirante në OGP sfidat dhe sukseset e saj në këtë fushë.” – theksoi Z. Genc Pollo, ministri për Inovacionin dhe TIK, njëkohësisht Kryetar i Grupit Ndërmnistror të Punës (GNP) për hartimin e plan veprimit të Shqipërisë për OGP-në në letrën e pranimit të Shqipërisë në OGP.